

Kantoni Jura

Një portret i shkurtër
Sistemi politik në Zvicër
Feja
Argëtimet

Një portret i shkurtër

Jura është një nga 26 kantonet e Zvicrës. Është kantoni më i ri dhe një nga më të vegjlit.

Shifra dhe fakte

Kantoni i Jura-së ka mbi 82'000 banorë. Afërsisht 15% janë persona të huaj. Sipërfaqja e kantonit të Jura-së është 858 km² dhe është e ndarë në 4 distrikte : Delémont, Porrentruy, Moutier dhe Franches-Montagnes. Ka 51 komuna. Çdo krahinë është e ndryshme nga kultura dhe ekonomia. Kryeqyteti është Delémont dhe flitet frëngjisht.

Historia

Para vitit 1815, territori i Jura-së i përkiste peshkopatës së Bâle. Më 1815, në Kongresin e Vjenës, iu dha kantonit të Bernit. Por banorët e Jura-së kanë ruajtur më tepër gjuhën dhe kulturën e tyre frankofone. Me kalimin e kohës, janë zhvilluar tensione ndërmjet kësaj pjese frankofone dhe pjesës tjetër të kantonit të Bernit. Në fillim të shekullit XX, u shfaq ideja e krijimit të një kantonit të ri. Më në fund, më 23 qershor 1974, banorët votuan për krijimin e kantonit të Jura-së, që u bë zyrtar më 1 janar 1979. Një pjesë e Jura-së (Jura bernese) ka mbetur në kantonin e Bernit. Qyteti i Moutier-it iu bashkua kantonit të Jurës më 1 janar 2026.

Traditat dhe festat

Zakonet e Jura-së janë të lidhura me festat fetare dhe me stinët.

- Në shkurt, lugina e Delémont dhe Franches-Montagnes festojnë Karnavalet
- Në pranverë, Delémont feston "Danse sur la Doux"
- Në verë, pothuajse çdo fshat ka një "festë fshati"
- Në gusht, Saignelégier tërheq mijëra vizitorë me Marché Concours National de Cheval (Tregu Konkurs Kombëtar i Kalit)
- Çdo dy vjet, fundjavën e fundit të gushtit, zhvillohet Braderia në Porrentruy në vitet çift (p.sh. 2026 pastaj 2028) dhe në Moutier në vitet tek (p.sh. 2027 pastaj 2029)..
- Në shtator, është festivali i muzikës "Chant du Gros" në Noirmont
- Në nëntor, në Ajoie festohet St-Martin

Prodhimet autentike të zonës

Kantoni i Jura-së është i njohur për prodhimet e tij vendore :

- Djathi Tête de Moine AOP (prodhim ndër-jurasian)
- L'eau-de-vie Damassine AOP (alkool i fortë)
- La Saucisse d'Ajoie IGP
- Le boudin është një salsiçe e bërë me gjak derri që hahet gjatë festës St-Martin

Shumë bujq dhe zejtarë krijojnë tjera prodhime rajonale cilësore. Çdo dy vjet, zhvillohet një konkurs i madh i prodhimeve autentike të zonës në Courtemelon.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/kantoni-jura/nje-portret-i-shkurter

Sistemi politik në Zvicër

Pushteti politik në Zvicër funksionon në tre nivele : Konfederata (për të gjithë Zvicrën), kantonet dhe komunat. Zakonisht, zvicëranët votojnë 4 herë në vit për të ndikuar në vendimet politike.

Konfederata zvicerane

Konfederata zvicerane, në formën aktuale, ekziston që prej vitit 1848. Kryeqyteti është Berne.

Zvicra është një shtet me shumë kultura, gjuhë dhe fe.

Është një shtet neutral në politikën ndërkombëtare.

Federalizmi

Zvicra është një vend federal, është një Konfederatë shtetesh. Do të thotë që është e përbërë nga disa shtete : kantonet. Kantonet kanë shumë autonomi.

Mund të vendosin vetë për shumë gjëra. Kjo quhet federalizëm.

Ka 26 kantone dhe më shumë se 2000 komuna, secili me organizimin e vet të veçantë.

Për shembull, kantoni i Jura-së ka kushtetutën e vet, qeverinë, parlamentin dhe gjykatat e veta.

Ligjet federale zbatohen për mbarë Zvicrën, por kantonet kanë po ashtu ligjet e tyre.

Edhe komunat mund të bëjnë ligje (rregullore).

Kantonet dhe komunat kujdesen për detyra të ndryshme si : arsimi, shëndeti, siguria dhe transportet.

Funksionimi i shkollave, për shembull, mund të jetë i ndryshëm sipas kantoneve dhe komunave.

Konfederata, kantonet dhe komunat mbledhin tatimet për të financuar shërbimet e tyre. Për shembull shkollat, spitalet, kulturën.

Ndarja e pushteteve

Në Zvicër, pushteti është i ndarë në tri pjesë :

- Legjislativ (i cili bën ligjet)
- Ekzekutiv (i cili zbaton ligjet). Ai punon, në mënyrë që ligjet të bëhen realitet në jetën konkrete.
- Gjyqësor (i cili bën që ligjet të zbatohen)

Pushtetet për tërë Zvicrën (niveli federal):

- Legjislativ : Asambleja federale. Ajo përbëhet nga Këshilli kombëtar (200 anëtarë) dhe Këshilli i shteteve (46 anëtarë). Anëtarët zgjidhen çdo 4 vjet nga populli
- Ekzekutiv: Këshilli federal (7 anëtarë të zgjedhur çdo 4 vjet nga Asambleja federale)
- Gjyqësor : disa gjykata kombëtare. Gjukata federale është instanca më e lartë (gjyqtarët dhe prokurorët zgjidhen nga Asambleja federale)

Pushteti në kantonin e Jura-së (niveli kantonal):

- Legjislativ: Parlamenti (60 anëtarë të zgjedhur çdo 5 vjet nga populli)
- Ekzekutiv : Qeveria (5 anëtarë të zgjedhur çdo 5 vjet nga populli)
- Gjyqësor : Gjukata kantonale (instanca e 2-të), Gjukata e shkallës së parë, Prokuroria dhe Gjukata për të miturit (gjyqtarët dhe prokurorët zgjidhen nga Parlamenti).

Pushteti në komuna (niveli komunal):

- Legjislativ : Asambleja komunale (ose Këshilli i përgjithshëm)
- Ekzekutiv : Këshilli komunal (ose bashkiak).

Të drejtat demokratike (marrja pjesë në votime dhe zgjedhje)

Të gjithë zviceranët mbi moshën 18 vjeç kanë të drejtën e votës dhe mund të zgjidhen. Ata votojnë për çështje politike, zgjedhin përfaqësues dhe mund të jenë kandidatë në nivelin komunal, kantonal dhe federal.

Në kantonin e Jura-së, të huajt, që jetojnë në Zvicër prej 10 vitesh dhe në kanton prej 1 viti, mund të votojnë në nivelin kantonal dhe komunal.

Ata edhe mund të zgjidhen në nivelin komunal (përveçse në bashki).

Iniciativat

Qytetarët mund të propozojnë ligje të reja (iniciativat popullore).

Për këtë, ata duhet të mbledhin një numër të caktuar nënshkrimesh (për Zvicrën: 100'000 nënshkrime dhe për kantonin e Jura-së: 2'000). Më pas, populli mund të votojë mbi këto iniciativa popullore.

Të drejtat themelore (e drejta për jetën, e drejta për mbrojtje, liritë)

Kushtetuta federale është ligji kryesor në Zvicër.

Ajo përshkruan funksionimin e Konfederatës dhe marrëdhëniet e saj me kantonet.

Ajo i garanton të drejta popullit dhe vendos objektivat e politikës zvicerane.

Në Kushtetutën federale janë të shënuara të drejtat themelore si:

le drejta për jetë, ndihma në rast emergjence, mbrojtja kundër çdo forme diskriminimi.

Diskriminimi (ose të diskriminosh), është ta trajtosh një person në mënyrë të pa drejtë, për shkak të origjinës së tij, racës së tij, fesë së tij, aftësive të kufizuara, seksit ose orientimit seksual të tij.

Në Zvicër, liria fetare, e opinionit, e organizmit në shoqata dhe e shtypit janë të garantuara.

Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) ofron një shërbim këshillimi për personat viktimë ose dëshmitarë të diskriminimeve në kantonin e Jura-së.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/kantoni-jura/sistemi-politik-ne-zvicer

Feja

Zvicra është një shtet i krishterë, por shumë persona kanë besime fetare të tjera. Liria fetare është e garantuar dhe shkollat publike janë neutrale në lidhje me fenë.

Feja dhe shteti

Zvicra është një shtet i krishterë. Secili kanton vendos për lidhjen ndërmjet fesë dhe shtetit. Në shumicën e kantoneve, Kishat e krishtera janë të njohura zyrtarisht. Kantoni i Jura-së njih Kishën katolike romake dhe Kishën e reformuar ungjillore (protestante). Kjo do të thotë që shteti u jep atyre disa të drejta dhe detyra. Për shembull, ato mund të mbledhin tatime në gjirin e anëtarëve të tyre.

Komunitetet fetare të kantonit të Jura-së

Në kantonin e Jura-së, shumica e njerëzve janë katolikë romakë (53%). Ka gjithashtu të krishterë të tjerë (7%) dhe myslimanë (2,5%). 16% të popullsisë deklarohen pa fe (sipas të dhënave statistikore më 31.12.2022).

Liria fetare

Kushtetuta zvicerane garanton lirinë fetare. Secili ka të drejtë të praktikojë dhe të shprehë fenë e vet. Askush nuk mund të detyrohet të bëjë pjesë të një komuniteti fetar ose të marrë pjesë në veprimtari fetare.

Të gjithë personat kanë të drejtë të mblidhen për të kremtuar ritualet fetare dhe festat. Asnjë person nuk duhet të diskriminohet për shkak të fesë së tij apo të bindjeve të tij.

Feja dhe shkolla

Shkolla publike e detyrueshme është neutrale në lidhje me fenë, por aty mund të jepen mësim temat fetare.

Lënda "Etika dhe kulturat fetare" (Éthique et cultures religieuses) në shkollë mundëson të zbulohen fetë e ndryshme dhe vlerat humaniste dhe fetare.

Disa komunitete fetare propozojnë edukimin fetar të tyre.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/kantoni-jura/feja

Argëtimet

Në kantonin e Jura-së, ka shumë mundësi për argëtimet (sport, muzikë, vallëzim). Shoqatat janë shumë të rëndësishme dhe mundësojnë takimin me njerëz tjerë.

Shoqatat

Shumë banorë të Jura-së janë anëtarë të një shoqate. Ka shoqata për të gjithë interesat. Për shembull, shoqata sporti apo muzike. Edhe në fshatrat e vegjël, gjejmë shoqata sportive dhe kulturore. Ato janë të hapura për të gjithë dhe mundësojnë takimin me njerëz të tjerë. Informacionet gjenden në sitet Internet të komunave.

Ofertat për të rinjtë

Kantoni i Jura-së propozon aktivitete të shumta për të rinjtë. Platforma Oxyjeune propozon të gjitha aktivitetet për të rinjtë në Jura dhe në Jura-në bernese. Në Delémont, në Le Noirmont dhe në Porrentruy, ka qendra të rinisë. Në këto qendra, të rinjtë mund të shkëmbejnë idetë dhe të realizojnë projektet e tyre. Zakonisht, aktivitetet janë falas. Në shumë fshatra, ka shoqata të rinjsh, të cilat organizojnë aktivitete në natyrë dhe mundësojnë takimet ndërmjet të rinjve.

Ekskursionet dhe kultura

Kantoni i Jura-së ofron mundësi të shumta ekskursionet dhe një ofertë kulturore të pasur. Ka qytete të vjetra historike, kështjella, lumenj dhe pellgje. Mund të bëhen shëtitje të bukura me biçikletë ose ecje në natyrë. Ka edhe shumë muze me ekspozita mbi tema të ndryshme. Jura Tourisme jep informacione mbi ekskursionet dhe ngjarjet. Edhe gazetat rajonale japin informacione mbi ngjarjet kulturore.

Karta kulturë (CarteCulture) për sport/kulturë/ trajnim më të lirë

Me CarteCulture (Kartën kulturë), personat me të ardhura të ulëta mund të paguajnë çmime më të lira për ngjarjet sportive, kulturore dhe të trajnimit. Karta mund t'i kërkohet Caritas-it që jep të gjitha informacionet e nevojshme.

Vullnetarizmi (të zgjedhësh të ndihmash falas)

Vullnetarizmi është një punë pa pagesë për të ndihmuar personat ose mjedisin.

Në Zvicër, shumë persona bëjnë punë në mënyrë vullnetare, pa marrë pagesë. Për shembull, për organizimin e një festivali ose për të dhënë mësimë frëngjishteje .

Një pjesë e madhe e kësaj pune bëhet në shoqata.

Secili mund të përfshihet Në shoqata për kulturën, sportin, ndihmën ndaj personave, trajnimin, mbrojtjen e kafshëve dhe të natyrës, shëndetin dhe shumë tjera.

Bénévolat Jura jep informacione mbi vullnetarizmin dhe mundësitë e përfshirjes.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/kantoni-jura/argetimet